REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

**Nr.Regj.Them. 616(01207)** **Vendim Nr.616(2925)**
**Dt. e ardhjes 07.07.2017** **Dt. 10.07.2017**

**VENDIM**
"NË EMËR TE REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder, e përbërë prej:

**SOKOL SHEHU – GJYQTAR**

Me sekretare seance gjyqesore Laura Gjipali, pasi shqyrtoi sot me date 10.07.2017, ne seance gjyqesore me dyer te mbyllura çeshtjen penale, qe i perket:

**KERKUESE**: Prokuroria prane Gjykates së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përfaqësuar nga prokurori **Astrit Hlilaj.**

**KUNDER** : Vendosjen e sekuestros preventive praneTirana Bank, te llogarive dhe depozitave bankare ne emer te shtetasit shqiptare [redacted], i datelindjes 06.01.1996, lindur dhe banues ne Malesi te Madhe.

**B.LIGJORE**: Nenet 274, 275 të K.Pr.Penale.

Gjykata pasi administroi provat,shqyrtoi çeshtjen ne teresi me dyer tw mbyllura, si dëgjoi konkluzionet përfundimtare të prokurorit i cili përfundimisht kërkoi:

**Prokurori**, kerkoi pranimin e kerkeses sipas objektit te saj;

**VEREN-se:**

Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder *(Gjykate kompetente sipas neneve 13/1.2.3;74/1 e 76/1 te Kodit te Procedures Penale)* eshte paraqitur per gjykim kerkesa penale me numer 616(01207) regjistri, date 07.07.2017 qe u perket paleve: kerkues Prokuroria e Rrethit Shkoder me objekt: *"Vendosjen e sekuestros preventive praneTirana Bank, te llogarive dhe depozitave bankare ne emer te shtetasit shqiptare* [redacted]*, i datelindjes 06.01.1996, lindur dhe banues ne Malesi te Madhe."*

**I. Rrethanat e Çështjes**

Pala kërkuese Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, i është drejtuar me kërkesë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku kërkon vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurinë e e luajtshme sipas objektit të kërkesës.

Rezultoi nga aktet e shqyrtuara se, mbi bazen e referimit të ardhur nga DVP, Shkodër, më shkresë nr.5507 prot, datë 03.07.2016, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkllës së Parë Shkodër, më datë 07.07.2017 është rregjistruar procedimi penal **nr. 943, i vitit 2016**, për vepren penale të ***"Pastrimit të porodukteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*** parashikuar nga neni 287 të K.Penal, në ngarkim të shtetasit [redacted].

Me shkresë nr.5507 prot, datë 03.07.2017, DVP, Shkodër ka referuar për ndjekje penale materialet në ngarkim të shtetasit [redacted], për vepren penale të ***"Pastrimit të porodukteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*** parashikuar nga neni 287 të K.Penal.

Sipas informacionit të referimit të vepres penale, shtetasi [redacted], lindur dhe banues në Malësi e Madhe, nga data 19.06.2017 deri më datë 28.06.2017, në llogarinë e tij bankare pranë Tirana Bankë, ka përfitura 10 transferta bankare nga shtetasi i huaj [redacted], **në vlerë totale 60.345 Euro**, 5 transferta janë dërguar nga Australia dhe 5-transferta nga Belgjika. Shtetasi [redacted] ka sqaruar se dërguesi i fondeve është kunati i tij ( bashkëshorti i motres).

Më datë 29.06.2017 shtetasi [redacted] ka kërkuar të tërheqë një shumë prej 24.000 Euro me arsyetimin se do të blejë një pronë, por nuk ka paraqitur kontratë shit-blerje apo porosie.

Nga verifikimet e metejshme ka rezultuar se në përbërjen familjare shtetasi [redacted] nuk ka moter, dhe ka ka bërë deklarim të rremë në bankë për lidhjen me dërguesin e parave, duke thënë se e ka burrin e motres.

Për një periudhë dy javore ka përfituar 60.000 euro, nëpërmjet transfertave të copëzuara të dërguara nga një shteas i huaj. Ka kërkuar të tërheqë një shumë nga këto para (24.000 euro) pa justifikuar qëllimin e përdorimit.

Nisur nga këto dyshime DPPP, në bazë të ligjit nr.9917, datë 19.05.2008, i ndyshuar, më urdhër nr.79, datë 30.06.2017 ka bërë bllokimin e përkohshëm të transaksioneve dhe llogarive në emër të [redacted], për një periudhë prej 72 orësh, pasi janë transaksione ty dyshimta.

Më pas është njoftuar Drejtoria për Hetimin e Krimit Ekonomiko-Financiar në Policinë e Shtetit, e cila rastin ja ka dërguar për kompetencë DVP, Shkodër e cila ka bërë referimin për vepren penale të "Pastrimit të produkteve të vepres penale" parashikuar nga neni 287 të K.Penal.

Sa më sipër, prokuroria pretendon se në rastin konkret ka të dhëna të mjaftueshme për të dyshuar se ndodhemi para kryerjes së vepres penale të *"Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"* parashikuar nga neni 287 të K.Penal, dhe se autor i kësaj vepre është shtetasi [redacted], ndaj disponimi i lirë i këtyre llogarive dhe depozitave bankare, mund të rëndojë pasojat e vepres penale, pasi paratë mund të tërhiqen, duke zgjatur pasojat e veprimeve dhe mosveprineve të paligjshme, ndaj lind nevoja qw në mbështetje te neneve 274, 275 te K. Pr Penale gjykata tw vendosi sekuestron preventive prane Tirana Bank, te llogarive dhe depozitave bankare ne emer te shtetasit shqiptare [redacted].

## II. Vlerësimi i Gjykatës.

Gjykata vëren se ndodhet përpara një kërkese me objekt vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurinë e paluajtshme sipas objektit të kësaj kërkese. Sekuestroja preventive është një ndër masat e sigurimit pasuror që parashikon K.Pr.Penale. Kjo lloj sekuestro gjen rregullim në nenin 274 të K.Pr.Penale, ku parashikohet se:" ***1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me***

***kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekeustrimin e tij me vendim të arsyetuar.*** *2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet sipas nenit 36 të Kodit Penal. 3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata me kërkesën e prokurorit ose të interesuarit, e heq sekuestron".*

Gjykata vëren se nga përmbajtja e dispozitës sa më sipër kusht për të vendosur sekuestron preventive, është që sendi mbi të cilin vendoset kjo masë lidhet me kryerjen e një vepre penale. Nga ana tjetër përveçse sendi, lidhet me kryerjen e një vepre penale, është e domsodoshme që disponimi i lirë i tij, mund të rëndojë ose zgjasë pasojat e veprës penale, ose lehtëson kryerjen e veprave penale të tjera në mungesë të sekuestros. Duke i'u rikthyer çështjes objekt gjykimi gjykata çmon se nga pala kërkuese u paraqitën prova të mjaftueshme për ekzistencën e dyshimit për kryerjen e veprës penale të " *Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*" parashikuar nga neni 287 të K.Penal.

Në vijim të arsyetimit sa më sipër nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, të paraqitura nga pala kërkuese krijohet dyshimi i arsyeshwm se pasuria e luajtshme shuma e parave prej 60.000 euro e depozituar prane Tirana Bank nw llogari te shtetasit shqiptar [redacted] " kanw ardhur si rezultat i transaksioneve tw dyshimta cka ngre dyshime tw forta se jemi para kryerjes së vepres penale të "*Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*" parashikuar nga neni 287 të K.Penal

Me shkresë nr.5507 prot, datë 03.07.2017, DVP, Shkodër ka referuar për ndjekje penale materialet në ngarkim të shtetasit [redacted], për vepren penale të "***Pastrimit të porodukteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale***" parashikuar nga neni 287 të K.Penal.

Sipas informacionit të referimit të vepres penale, shtetasi [redacted], lindur dhe banues në Malësi e Madhe, nga data 19.06.2017 deri më datë 28.06.2017, në llogarinë e tij bankare pranë Tirana Bankë, ka përfitura 10 transferta bankare nga shtetasi i huaj [redacted], **në vlerë totale 60.345 Euro**, 5 transferta janë dërguar nga Australia dhe 5-transferta nga Belgjika. Shtetasi [redacted] ka sqaruar se dërguesi i fondeve është kunati i tij ( bashkëshorti i motres).

Më datë 29.06.2017 shtetasi [redacted] ka kërkuar të tërheqë një shumë prej 24.000 Euro me arsyetimin se do të blejë një pronë, por nuk ka paraqitur kontratë shit-blerje apo porosie.

Nga verifikimet e metejshme ka rezultuar se në përbërjen familjare shtetasi [redacted] nuk ka moter, dhe ka ka bërë deklarim të rremë në bankë për lidhjen me dërguesin e parave, duke thënë se e ka burrin e motres.

Për një periudhë dy javore ka përfituar 60.000 euro, nëpërmjet transfertave të copëzuara të dërguara nga një shteas i huaj. Ka kërkuar të tërheqë një shumë nga këto para (24.000 euro) pa justifikuar qëllimin e përdorimit.

Nisur nga këto dyshime DPPP, në bazë të ligjit nr.9917, datë 19.05.2008, i ndyshuar, më urdhër nr.79, datë 30.06.2017 ka bërë bllokimin e përkohshëm të transaksioneve dhe llogarive në emër të [redacted], për një periudhë prej 72 orësh, pasi janë transaksione ty dyshimta.

Më pas është njoftuar Drejtoria për Hetimin e Krimit Ekonomiko-Financiar në Policinë e Shtetit, e cila rastin ja ka dërguar për kompetencë DVP, Shkodër e cila ka bërë referimin për vepren penale të "Pastrimit të produkteve të vepres penale" parashikuar nga neni 287 të K.Penal.

Pra, sa më sipër ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova, se këto shuma parash ne vlerwn totale prej 60.000 euro tw depozituara prane Tirana Bank nw llogari te shtetasit shqiptar [redacted]

[redacted] " kanw ardhur si rezultat i transaksioneve tw dyshimta dhe ka dyshime të bazuara se ndodhemi para kryerjes së vepres penale të "*Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*" parashikuar nga neni 287 të K.Penal, dhe se autor i kësaj vepre është shtetasi [redacted].

Në këto kushte, kur ka dyshime të bazuara se se ndodhemi para kryerjes së vepres penale të "*Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*" parashikuar nga neni 287 të K.Penal, dhe se autor i kësaj vepre është shtetasi [redacted], gjykata vlerwson se disponimi i lirë i këtyre llogarive dhe depozitave bankare, mund të rëndojë pasojat e vepres penale, pasi paratë mund të tërhiqen, duke zgjatur pasojat e veprimeve dhe mosveprineve të paligjshme, ndaj lind nevoja qw në mbështetje te neneve 274, 275 te K. Pr Penale gjykata tw vendosi sekuestron preventive prane Tirana Bank, te llogarive dhe depozitave bankare ne emer te shtetasit shqiptare [redacted].

Pra, si përfundim, gjykata vlerëson se kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme sipas objektit të kërkesës është e bazuar në ligj dhe në prova, si e tillë duhet pranuar.

**PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata bazuar në nenet 274, 275 të Kodit të Procedurës Penale

**VENDOSI:**

1. Pranimin e kërkesës.
2. Vendosjen e sekuestros preventive te llogarive dhe depozitave bankare prane Tirana Bank ne emer te shtetasit shqiptare [redacted], i datelindjes 06.01.1996, lindur dhe banues ne Malesi te Madhe.
3. Kundër këtij vendimi pala kërkuese mund të bëjë ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit, ndërsa personat e interesuar mund të bëjnë ankim brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni për sekuestron e vendosur.

**U shpall ne SHKODËR, sot me date 10.07.2017.**

**Sekretare Seance**
**LAURA GJIPALI**

**GJYQTAR**
**SOKOL SHEHU**